



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA

Puke, 28 .08.2025

Nr. 1482 prot.

Procesverbal i mbledhjes se kryesise se keshillit , i mbajtur sot me date 28.08.2025 :

Te njoftuar per mbledhje :

1. Gjon Gjoka
2. Enver Sulejmani
3. Dritan Asani
4. Besar Kuçi
5. Alfons Gjegjaj
6. Hazbi Terbuni

Moren pjese:

- 1 Gjon Gjoka
- 2 Dritan Asani
- 3 Besar Kuçi
- 4 Hazbi Terbuni

Tematika e mbledhjes eshte : Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së rradhës të Këshillit Bashkiak” per muajin Gusht-Shtator 2025

Mbledhjen e hapi kryetari i keshillit z. Gjon Gjoka, i cili prezantoi projekt-rendin e dites te pergatitur paraprakisht ne bashkepunim me kryetarin e Bashkise dhe administraten e bashkise si me poshte vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 25.07.2025
2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Korrik** 2025.
3. Projekt- vendim : Për heqjen nga kontabiliteti i detyrimeve të prapambetura, që nuk justifikohen me dokumentacion financiar dhe ligjor.
4. Projekt-vendim ” Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e Personit Juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë , për rritjen e kapaciteteve të Qeverisjes Vendore, Akademia e trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, të Republikës së Shqipërisë (TALGA)
5. Projekt-vendim : Për shtyrjen e afatit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë 2022-2025 me një vit shtesë
6. Projekt-vendim ”Për miratimin e planit social të Bashkisë Pukë 2025-2028

7. Projekt-vendim : “Per miratimin e planit per Arsimin Parauniversitar 2025-2028”

8. Projekt-vendim : Për miratimin projektit me objekt “Masa parandaluese të gerryerjes së tokave bujqësore nga ujrat e larta dhe sistemimi i tyre , fshati Gomsiqe, Njësia administrative Qerret, Bashkia Pukë” me fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.

9. Projekt-vendim: Për miratimin e projektit me objekt : “ Masa parandaluese të bodrumit të pallatit nr.50 , i dëmtuar nga ujrat e zeza, Njësia administrative Pukë, Bashkia Pukë, me fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.

10. Të tjera.

Ne perfundim te mbledhjes kryesia , pas diskutimit te anetareve vendosi te miratoje te gjitha pikat e projekt-rendit te dites, dhe mori Vendimin nr.5 date 28.08.2025, ku u percaktua data dhe ora e zhvillimit te mbledhjes se keshillit, detyrat per sekretarin e keshillit per berjen publike te njoftimit dhe dergimin e materialeve te pergatitura per mbledhjen e keshillit , sipas rendit te dites se miratuar. Po keshtu u percaktua dhe data dhe ora e mbledhjes se komisioneve te perhereshme te keshillit, sipas shenimit ne fund te procesverbalit.

Shënim: Mbledhjet e komisioneve të përherëshme të këshillit zhvillohen më datë 03. 09 .2025 , nga ora 14-³⁰ deri ne oren 16 ⁰⁰ në zyrën e sekretarit të këshillit.

Kryetari I keshillit
Gjon Gjoka





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA**

Nr. 1482/1 prot.

Puke, me 28 .08 .2025

VENDIM

Nr. 5 datë 28 .08 .2025

“Për miratimin e rendit të ditës të mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr.14 datë 30/06/2020, neni 57, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 28 .08 .2025;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të zhvillohet më datë 04.09 .2025, ora 13³⁰.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit të rendit të ditës, si dhe dosjen me materialet e mbledhjes tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Gjon Gjoka

